Ac.nr.3585/16

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Faton Ademi - kryetar i kolegjit, Rrustem Thaqi dhe Mehmet Ndrecaj, anëtar të kolegjit, me zyrtarin ligjor Faton Xhaqkaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses: M.B. nga Prishtina, të cilën e përfaqëson N.H. Av. nga Prishtina, kundër të paditurës: Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike – Prishtinë, të cilin e përfaqëson I.G., jurist i diplomuar, për kompensimin e të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.388/2013, i datës 07.03.2016, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë **03.07.2019**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurës: Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike – Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.388/2013, i datës 07.03.2016, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar, C.nr.388/2013, i datës 07.03.2016, në pikën e I-rë të dispozitivit ka vendosur që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Mejreme Bajqinovci nga Prishtina.

Në pikën e II-të të dispozitivit ka vendosur që të detyrohet e paditura Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike – Prishtinë, që paditëses në emër të të ardhurave personale për periudhën prej 02.06.2009 gjerë me datë 30.11.2010, t'ia kompensoj shumën e pagës mujore prej 273 euro, për 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, gjegjësisht shumën e përgjithshme prej gjithsej 4.914.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Në pikën e III-të të dispozitivit ka vendosur që të detyrohet e paditura që paditësit ti kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore edhe atë për përpilimin e padisë 104 euro, përfaqësim për dy seanca gjyqësore nga 135 shumën prej 270 euro (dyqind e shtatëdhjetë euro), për taksë gjyqësore shumën prej 25 euro, si dhe shumën prej 25 euro, për përpilim të aktgjykimit gjithsej shumën prej 424 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij Aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, duke e atakuar Aktgjykimin e goditur për shkak të, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të prishet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.388/2013, i datës 07.03.2016, dhe çështja të kthehet në rigjykim , apo të ndryshohet dhe të vendos lidhur me kërkesëpadinë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitu paditësi duke i propozuar Gjykatës së Apelit që të refuzohet ankesa e të padituës, ndërsa të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë C.nr.388/2013, i datës 07.03.2016, në tersi i bazuar.

Gjykata e Apelit si Gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të padituës është e pa themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi M.B. me datë 13.03.2013, ka paraqitur padi ndaj të padituës Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike – Prishtinë, për kompensimin e të ardhurave personale.

Gjykata e shkallës së parë, me datë 07.03.2016 është mbajtur seanca gjyqësore, në të cilën janë administruar prova dhe janë dëgjuar palët në procedurë. Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, dhe pas mbajtjes së seancës se shqyrtimit gjyqësor, ka nxjerrë Aktgjykimin e atakuar C.nr.388/2013, i datës 07.03.2016, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të Aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të Aktgjykimit të atakuar, ndër të tjera ka theksuar se: nga provat e administruara gjykata fitoi bindjen se paditëses i takon kompensimi i të ardhurave personale, për periudhën kontestuese, pasi që paditëses me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyes Civil të Kosovës, A.02/42/2009, të datës 02.05.2009, të formës së prerë, i është aprovuar ankesa dhe janë anuluar të gjitha veprimet procedurale dhe është detyruar e paditura që paditëses në afat prej 30 dite, pas marrjes së këtij vendimi paditësen ta sistemoj ne vendin e punës në pajtim me lëmin e specializimit mjek specialist për Shëndet Publik.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë gjykata është mbështetur në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, 09/26, të datës 09.07.2008, në të cilin theksohet se mjekët specialist do ti kenë pagat mujore në vlerë prej 273 euro, pasi që nuk ishte kontestuese në mes të palëve. Meqenëse paditësit pa bazë ligjore nuk i janë kompensuar të ardhurat personale për periudhën kontestuese, gjykata aprovoi kërkesëpadinë në shumën e gjykuar duke u bazuar në dispozitat ligjore nga nenin 66 të Ligjit të punës, si dhe nga neni 154 të LMD-së. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit

194 të LPK-së, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurit se Aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore - LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i Aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e Aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Në raport me pretendimet e të padituës se me vendimin e KPMSHC-së, nuk cekët se e paditura duhet t'ia bëjë kompensimin e pagave (pa punuar), apo fitimin e humbur, Gjykata e Apelit e refuzon si te pa bazuar këtë pretendim të paditësit par arsye se KPMSHC nuk ka mundur të caktoj në vendim kompensimin e pagës sepse e drejta në këtë kompensim ka filluar të rrjedhë 30 ditë pas marrjes së vendimit të KPMSHC-së. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vepruar kur e ka detyruar të padituën në kompensimin e shumës si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në raport me pretendimet e të padituës se nuk mund të paguhet paditësi për kohën sa e njëjta nuk ka punuar, Gjykata e Apelit këtë pretendim e refuzon si të pa bazuar për faktin se vendimi i KPMSHC-së, është bërë i plotfuqishëm dhe e paditura ka qenë e obliguar që 30 ditë pas vendimit të KPMSHC-së, paditësin ta sistemoj në punë, pasi vendimi i KPMSHC-së ka konstatuar se marrëdhënia e punës veç se është themeluar dhe për këtë qëllim i ka jep afat 30 ditor për sistemin ndërsa pas kalimit të këtij afatit paditëses i rrjedhin të drejtat në punë më konkretisht e drejta në pagë, sepse e njëjta pa fajin e saj nuk ka mundur të filloj punën.

E paditura pakënaqësitë/ankesat e veta në raport me vendimin e KPMSHC-së është dashur t'i paraqes në procedurë administrative, për inicimin e konfliktit administrativ për anulimin e vendimit të KPMSHC-së, por jo të refuzoj në mënyrë të heshtur zbatimin e vendimit të këtij organi, vendime të cilat për nga natyra janë të detyrueshme për të gjitha institucionet të cilave iu drejtohet, sepse të njëjtat mund të shërbejnë si titull ekzekutiv për përmbarim.

Në raport me lartësinë e pagesës, këtë fakt nuk e ka kontestuar e paditura në procedurë para gjykatës e as me mjet të goditjes, dhe drejtë e ka vërtetuar këtë fakt gjykata e shkallës së parë se kjo është në përputhje të plotë me vendimin e Qeverisë së Kosovës për kohën të cilës i referohet e cila cekët në paragrafët më lartë në këtë vendim.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet e tjera të paditësit po gjeti se të njëjtat nuk kanë ndonjë rëndësi, për një vendim ndryshe, andaj edhe Aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë e vlerësoi të drejt dhe të ligjshëm, sepse pala e paditur është orientuar vetëm në pretendime dhe se

me asnjë fakt apo provë konkrete nuk ka dëshmuar se paditëses nuk i takon kompensimi në të ardhura personale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3585/16, me datë 03.07.2019

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari

Faton Ademi